



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL  
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 539/prot.  
1

Tiranë, më 30.3.2021

VENDIM

Nr. 4, datë 30.3.2021

PËR

**DHËNIEN E PËRJASHTIMIT PËR TRANSPORTIN E VAKSINAVE NË KABINËN E PASAGJERËVE GJATË PANDEMISË COVID-19**

Në mbështetje të nenit 13, pika g, të Ligjit Nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, dhe në zbatim të Ligjit Nr. 96/2020 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr. 1095, date 24.12.2020, “Miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e Aviacionit Civil”, duke analizuar rrethanat dhe situatën e krijuar për vaksinimin e popullsisë ndaj pandemisë të Covid-19:

**V E N D O S A:**

1. Dhënie e përjashtimit “Për transportin e vaksinave kundër pandemisë COVID-19 në kabinën e pasagjerëve deri në 30 Nentor 2021, nga paragrafët e CAT.IDE.A.100, CAT.OP.MPA.160 të Urdherit të Ministrit Nr. 59/2020, 21.A.181 të Urdhërit të Ministrit Nr. 326/2019, M.A.304, M.A.501, M.A.902(b)(2) dhe M.A.902(b)(5) të Urdhërit të Ministrit Nr. 167/2020 për komponentët/pjesët që kanë të bëjnë me fiksimin/sigurinë e mallrave gjatë transportit në kabinë dhe modifikimi/riparimi i tyre.
2. Ky përjashtim zbatohet për “Air Albania” sh.p.k
3. Ky përjashtim është subjekt i kushteve të:
  - Zbatimit të Vendimit të AAC-se Nr. 23, datë 12.06.2020, “Manuali Udhëzues për Transportin e Ngarkesave në Kabinën e Pasagjereve”;

- Zbatimit të masave mitiguese dhe të vlerësimit të riskut të nxjera nga operatori dhe të pranuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil;
- “Air Albania” sh.p.k. do të njoftoje Autoritetin e Aviacionit Civil të paktën 48 orë përpara nisjes/uljes në Aeroportin “Nënë Tereza”

4. Ky përjashtim është në fuqi deri në datë 30.11.2021 në 23:59 ECT;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**Edlira Kraja**

